

08.09.2021

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ FIDUS ADVISORY” SHPK

Neni 1

Sipas Legjislacionit shqiptar, Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe shoqerite Tregtare “ ne te quajturit Franko Frederik Bare, i datelindjes 08/08/1992, lindur ne Fier dhe banues ne Tirane, dhe Daniel Viktor Davidhi, i datelindjes 07/08/1990, lindur ne Fier, banuese ne Tirane me zotesi te plote juridike per te vepruar shpallim formimin e shoqerise private tregtare me pergjegjesi te kufizuar (SH.P.K.) te quajtur “ FIDUS ADVISORY “ SHPK

Neni 2

Shoqeria si person juridik zhvillon verprimtarine e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise , ne perputhje me legjislacionin ne fuqi , statutin dhe kete akt themelimi

OBJEKTI I SHOQERISE

Neni 3

Objekti i shoqerise eshte:

- **Sherbime konsulence te biznesit dhe menaxhimit.**
- **Kryerja e raportimit financiar dhe pergatitja e pasqyrave financiare, sherbime kontabel, regjistrim te dhenash kontabel, sherbime keshillimi, sherbime fiskale, sherbime te keshillimit ligjor personave juridik (publik dhe/ose privat) ose individeve, sherbime investigimi ne lidhje ceshtje financiare ndermjet paleve.**
- **Sherbime te lidhura me transaksionet e blerjes dhe shitjes se kapitaleve/aksioneve**
- **Sherbime te vleresimit te aseteve e te biznesit.**
- **Sherbime ligjore.**
- **Veprimtari te tjera te lejuara me ligj.**

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 4

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100.000 Lek.** i cili do te ngurtesohet ne llogari bankare te shoqerise pas rregjistrimit ne QKB.

Ky kapital themeltar eshte vene ne masen 50% nga ortaku Franko Bare dhe 50% nga ortaku Daniel Davidhi.

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose pakesohet me te gjitha menytrat e lejuara nga ligji

SELIA E SHOQERISE

Neni 5

(1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën **Rruga Marko Bocari, Pallati TID, Apartamenti Nr 20, Tiranë, Shqipëri**

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:

barefranko@gmail.com

Shoqeria mund te hape edhe vendqendrim te tjera operative dhe filjale ne territorin e Republikes se Shqiperise

AFATI I VEPRIMTARISE

Neni 6

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine saj mbi 10 vjet.

Aktiviteti saj mund te zgjase me shume se dhjete vjet , por eshte e mundur te nderpritet ne cdo kohe me vendim te ortakeve, sipas rasteve te parashikuar ne statut .

Neni 7

Shoqeria mban pergjegjesi per te gjitha detyrimet fiskale dhe sigurimet shoqerore per personat e siguruar .

Neni 8

Shoqeria fillon zotesine per te vepruar me regjistrimin e saj ne QKB .

Neni 9

Shoqeria fillon aktivitetin e saj tregtar , ne momentin e regjistrimit ne organet kompetente shteterore.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 10

Menyra dhe drejtimi i shoqerise jane parashikuar ne statutin e shoqerise
Administrator i shoqerise eshte **Franko Bare** me nje afat 5-vjecar me te drejte rizgjedhje.

Neni 11

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne baze te legjislacionit te punes me kontrata individuale dhe kolektive te punes midis shoqerise dhe te punesuarve .

Neni 12

Shoqeria ka vulen e saj ne te cilen shkruhet "**FIDUS ADVISORY**" shpk
Shoqeria ka logon e saj.

VLEFSHEMRIA E AKTIT TE THEMELIMIT

Neni 13

Ky akt themelimi eshte lidhur per nje periudhe jo me pak se dhjete vjet , por ky afat mund te ndryshoje sipas vendimit qe mund te marrin ortakët themelues.

ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

Neni 14

Te gjithamosmarrveshjet qe mund te lindin ne veprimtarine e shoqerise , do te zgjidhen nga Gjykata , ne rast se nuk do te zgjidhen me mirekuptimin e konsensus

Neni 15

Ceshtjet qe nuk jane trajtuar ne kete akt themelimi , rregullohen ne statutin e shoqerise si pjese perberese e saj.

Neni 16

Ne rast se shoqeria do te pushoje veprimtarine e saj , sipas rasteve te percaktuara ne statut , atehere do te caktohet nje komision likuidimi i cili do te paraqese bilancin e likuidimit .

Neni 17

Ky akt themelimi hyn ne fuqi ne daten e nenshkrimimit nga ortaket themelues te shoqerise .

ORTAKET THEMELUES

FRANKO BARE



DANIEL DAVIDHI

